

1 E mërkurë, 13 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Z. Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar.

9 Kjo është lënda KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar
10 kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Pikë së pari di t'ju kërkoja të prezantoheshim.

14 Z. Prokuror, fjala është për ju.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar. Sot

16 nga Prokuroria është Cezary Michalczuk, Prokuror; Line

17 Pedersen, Administratore e Çështjes; dhe Filippo de Minicis,

18 Ndhmësprokuror.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Mbrojtësja e Viktimave.

21 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Sot përfaqësohemi nga unë,

22 Brechtje Vossenberg.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala

24 Mbrojtëse, fjala është për ju.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Pala Mbrojtëse përfaqësohet sot

1 nga bashkë mbrojtësi Betim Shala; unë Avokati Julius von Bone;
2 edhe Fatmir Pelaj, hetues dhe përkthyes. Dhe në sallën e
3 gjyqit kemi edhe z. Salih Mustafa, të akuzuarin.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
5 procesverbal, sot jeni përpara Trupit Gjykes I.

6 Sot do të dëgjojmë dëshminë e dëshmitarit numër 1001, që
7 është z. Rrahimi, Sheqir Rrahimi.

8 Para se të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 1001, dua
9 të informoj palët dhe Mbrojtësen e Viktimave sikur iu
10 komunikua Mbrojtjes me email të premtën më 8 prill, në orën
11 15.58, Trupi Gjykes nuk synon të ketë seanca në datat 2,4 dhe
12 5 maj, për çështje organizative edhe po ashtu edhe për faktin
13 se më 3 maj është ditë pushimi si në Kosovë dhe në Dhomat e
14 Specializuara të Kosovës.

15 Synojmë të rifillojmë me seancat pas pushimit të prillit
16 në datat 11 maj, 12 maj dhe 13 maj në varësi të
17 disponibilitetit të Mbrojtjes.

18 A na konfirmon Mbrojtja se janë të disponueshëm të
19 fillojnë më 11 maj, të mërkurën, 2022?

20 Avokat i Mbrojtjes, fjala është për ju.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, jemi të
22 disponueshëm më 11 maj. Sidoqoftë, mund të ketë një ndryshim
23 të vogël në përbërjen e ekipit tim.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit.

1 Tani mund të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të
2 Mbrojtjes, Dëshmitari 1001.

3 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem sillni dëshmitarin në
4 sallën e Gjyqit. Faleminderit.

5 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
7 Rrahimi, mirëmëngjesi dhe mirë se erdhe në Dhomat e
8 Specializuara. A më dëgjoni mirë?

9 DËSHMITARI: Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë. Pikë së pari, si je?

12 DËSHMITARI: Mirë, faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
14 Z. Rrahimi, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Ju kemi
15 thirrur të dëshmoni para Dhomave të Specializuara në çështjen
16 Prokuroria e Specializuar kundër Salih Mustafës, në mënyrë që
17 të ndihmoni Trupin Gjykes të arrijë në një vendim.

18 Pasi të bëni deklaratën solemne, betimin, do t'ju
19 drejtojnë pyetje pala Mbrojtëse, që është në atë krah të
20 sallës; përfaqësuesit e Dhomave të Specializuara, që janë në
21 këtë kah, me këto togat ngjyrë lejla, vjollcë; si dhe
22 Mbrojtësja e Viktimave, ekipi që është më pranë jush. Dhe në
23 fund mund të ketë disa pyetje nga Trupi gjykues.

24 Shoh që pohon me kokë. E kuptuat këtë?

25 DËSHMITARI: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
2 doja t'ju jepja disa udhëzime për mënyrën si t'ju përgjigjeni
3 pyetjeve që do t'ju bëjnë. Z. Rrahimi, ju lutem dëgjoni me
4 vëmendje secilën prej pyetjeve. Nëse nuk e kuptoni, lirisht
5 kërkoni që pyetja të përsëritet.

6 Ne duam të thoni të vërtetën, kështu që ju lutem, ndani
7 me ne çka keni parë, çka keni dëgjuar, çka keni përjetuar, çka
8 keni ndjerë. Nëse i keni zbuluar gjërat në një formë tjetër,
9 na e thoni si, na e shpjegoni si i keni marrë vesh.

10 Mbase nuk ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve,
11 është krejt normale kjo gjë. Ju lutem dëshmoni bazuar mbi ato
12 çka mbani mend. Nuk ka asgjë të keqe të thuash "s'e di", "s'e
13 mbaj mend" .

14 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve. Përqendrohuni tek pyetja.
15 Nëse kemi nevojë për qartësi të mëtejshme, do ju kërkojmë ne
16 dhe do ju bëjmë pyetje të mëtejshme.

17 Nëse shohim që po devijoni nga pyetja, mund t'ju ndërpres
18 në mënyrë që t'ju kthej tek thelbi i pyetjes.

19 Po ashtu ju kujtoj se mund të refuzoni t'i përgjigjeni
20 pyetjeve lidhur me aspekte që mund t'ju inkriminojnë.

21 I kuptuat të gjitha këto?

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
24 mirë. Do të doja t'ju jepja po ashtu disa këshilla praktike
25 lidhur me dëshminë. Z. Rrahimi, çdo gjë që themi këtu

1 përkthehet dhe regjistrohet. Është shumë e rëndësishme të
2 flisni para mikrofonit, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë,
3 në mënyrë që çdo gjë që thoni ju të përkthehet dhe të
4 regjistrohet.

5 Duhet të filloni të flisni vetëm pasi personi që ju ka
6 marrë në pyetje e ka mbaruar pyetjen. Pra, kur ju bëjnë një
7 pyetje ju drejtojnë një pyetje, numëro deri në 5 dhe vetëm pas
8 kësaj përgjigju. Kjo është shumë e rëndësishme dhe e theksoj
9 shumë këtë, sepse këto 5 sekonda janë shumë të rëndësishme që
10 ne të ndjekim siç duhet çka është thënë në sallën e gjyqit.

11 Nëse unë ngre dorën, ndalo së foluri, pusho së foluri.
12 Nuk do them me zë "ndalo", sepse pastaj na mbivendosen zërat,
13 kemi përplasje të zërave dhe është e pamundur për përkthyesit
14 pastaj që të përkthejnë.

15 Ndonjëherë do ju kërkoj të hiqni dëgjueset, t'i vendosni
16 në tavolinën që keni përpara, në rastet kur kemi nevojë të
17 diskutojmë përmbajtjen e një pyetje që ju është drejtuar. Ose
18 mund të kërkojmë që t'ju shoqërojnë jashtë sallës së gjyqit.

19 Po ashtu është shumë rëndësishme që nëse ju keni një
20 pyetje, keni nevojë për pushim, apo keni nevojën për diçka
21 tjetër, ngrini dorën dhe unë do ju jap fjalën në mënyrë që të
22 na thoni se çka keni nevojë.

23 I kuptuat të gjitha këto?

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë. Faleminderit.

2 Z. Rrahimi, flisni anglisht?

3 DËSHMITARI: Jo.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Sikurse e bëjmë me çdo dëshmitar, do ju kërkojmë tani të
7 lexoni deklaratën solemne, ku të thoni të vërtetën. Dhe ju
8 kujtoj se është vepër penale në juridiksionin e Dhomave të
9 Specializuara të jepni dëshmi të rreme.

10 E kuptoni këtë?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Asistente e Gjykatës, ju lutem ndihmojeni dëshmitarin me
14 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën.

15 Ju lutem z. Rrahimi, lexoni tekstin që keni përpara.

16 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
17 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
18 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
19 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dije.

20 DËSHMITARI: SHEQIR RRAHIMI

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit z. Rrahimi. Tani jeni betuar për të thënë të
23 vërtetën.

24 Faleminderit Sekretaria.

25 Tani mund të fillojmë me dëshminë e z. Rrahimi, duke

1 filluar me palën Mbrojtëse. Dhe Trupi Gjykues e ka autorizuar
2 palën Mbrojtëse që pyetjet t'i bëj në shqip. Këtë e ka bërë me
3 anë të emalit të datës 8 prill, ora 15.56.

4 Avokat, ju keni një orë për të bërë pyetjet kryesore për
5 këtë dëshmitar. Ju lutem informojeni Trupin Gjykues nëse ka
6 ndonjë ndryshim, me qëllim që të mund të planëzojmë pjesën
7 tjetër të ditës.

8 Z. SHALA: [Përkthim] Sigurisht që do t'ju lajmërojmë, e
9 nderuara Gjykatëse. Faleminderit.

10 Pyetje nga Z. Shala:

11 Py. Mirëdita z. Dëshmitar.

12 Pë. Mirëdita.

13 Py. Z. Dëshmitar, unë sot dëshiroj të bisedoj me ju,
14 përkatësisht të na tregoni për ngjarjet që kanë ndodhur në
15 Kosovë gjatë vitit 1999. Nga janari i vitit 1999 dhe deri në
16 qershor të po të njëjtit vit, ku keni jetuar?

17 Pë. Në Orllan.

18 Py. Gjatë kësaj periudhe kohore, si ka qenë situata e
19 sigurisë në Orllan dhe përreth Orllanit?

20 Pë. Shumë e vështirë.

21 Py. Kur thoni "shumë e vështirë", a mund të na tregoni pse ka
22 qenë shumë e vështirë?

23 Pë. Po. Ne jemi një brez kufitar me Serbinë edhe popullata ka
24 qenë shumë e vuajtur prej forcave serbe. Kena pas shumë
25 tortura prej policisë serbe, maltrajtime jashtëzakonisht të

1 mëdha.

2 Py. Po gjatë kësaj periudhe kohore, pra prej janarit të vitit
3 1999 e deri në qershor të vitit 1999, a ka pas veprime
4 luftarake në atë pjesë?

5 Pë. Po.

6 Py. Ju në atë kohë, a keni qenë anëtar i Ushtrisë Çlirimtare?

7 Pë. Po.

8 Py. E cilës brigadë i keni?

9 Pë. 151.

10 Py. A keni pas ndonjë pozitë? Në pozitë komanduese në
11 brigadën 151?

12 Pë. Jo. Pozita veç çlirimin e atdheut dhe të kombit kam pas.

13 Py. Gjatë periudhës kohore janar 1999 dhe qershor 1999, a
14 keni përjetuar ju dhe a keni marrë pjesë në ndonjë ofensivë?

15 Pë. Pjesë nuk kam marrë, përjetuar, po.

16 Py. Gjatë atyre ofensivave, a ka pas persona ushtarë, civilë,
17 të lënduar dhe të vrarë?

18 Pë. Po.

19 Py. Ju konkretisht a i keni përjetuar këto, a keni pa civile
20 apo ushtarë të lënduar apo të vrarë?

21 Pë. Po.

22 Py. A mund të na tregoni për ndonjë rast të tillë?

23 Pë. Po.

24 Py. Kur ka ndodhur ajo?

25 Pë. Beteja ka ndodh më 16, më fal më 9 prill. Beteja në

1 fshatin e quajtur Surdull.

2 Py. Dhe fshati Surdull sa larg është fshatit ku ju jetoni?

3 Pë. Në vijë ajrore 2 kilometra, 3. S'jam i saktë kështu, po
4 aq. S'mundet me pas ma shumë.

5 Py. Ju thatë se ofensiva ka ndodh më 9 prill në fshatin
6 Surdull. Kush e ka ndërmarrë këtë ofensivë?

7 Pë. Forcat serbe.

8 Py. Ju personalisht, a keni qenë në Surdull apo keni qenë në
9 Orllan?

10 Pë. Unë kam qenë në fshatin Turiqicë.

11 Py. Dhe si e keni kuptuar që janë vrarë dhe janë lënduar
12 civilë apo ushtarë gjatë atij sulmi, gjatë asaj ofensive?

13 Pë. A mundem me elaboru pak ma gjatë?

14 Py. Po, urdhëro.

15 Pë. Më 9 prill forcat serbe kanë marrë një aksion në fshatin
16 e quajtur Surdull.

17 Më 10 prill 1999, është plagos Komandant Leka, Nuredin
18 Ibishi, me gjithë Korab Parduzin, Kapllan Parduzin me
19 pseudonimin Korabi. Në atë pjesën në fshatin Turiqicë e gjithë
20 popullata e Llapit, tuj ja nis prej Bradash, Llapashticë,
21 Dobratin, ka qenë fshatin -- përreth Orllanit, fshatrat
22 Turiqicë, Rakinicë, Muhazob, Krushevicë.

23 Py. E ju si e kuptuat që janë plagos Nuredin Ibishi dhe
24 Kapllan Parduzi?

25 Pë. Gjatë, se ne bëjshim furnizimin e popullatës, tu shpjer

1 ndihma popullatës, miell edhe sende elementare që mundnim me
2 siguru, najlon për mbulesë se njerëzit flinin në pyll në
3 fushë. Edhe popullata normal që e kishte dëgjuar atë ngjarje
4 edhe u folte nëpër popullatë.

5 Atëherë kur kam dëgju që u plagos Komandant Leka, ka qenë
6 një spital i improvizuar. Mund ta quash spital, por nuk ka
7 qenë spital ajo. Ka qenë stallë me një tepi dhe do sfungjera.
8 Edhe kam shkue në atë spitalin e improvizuar e kam pa gjendjen
9 e Nuredin Ibishit dhe Korab Parduzit. Aty ka pas edhe të tjerë
10 qytetarë edhe fëmijë të plagum.

11 Py. Z. Dëshmitar, pse ju shkuat ta vizitonit Nuredin Ibishin?

12 Pë. Me e vizitue, se Nuredin Ibishin e kam vendas. Është i
13 Orllanit. E kam edhe kushëri, jemi të një gjakut. Edhe e
14 ndjesha obligim moral njerëzor me shku me e vizitu dhe nëse ka
15 mundësi me e ndihmu diçka.

16 Py. Kapllan Parduzin, a e keni njoh në atë kohë?

17 Pë. Jo.

18 Py. Z. Dëshmitar, kur e vizituat Nuredin Ibishin, a mujtët me
19 vërejt ku ishin të plagosur?

20 Pë. Po. Kapllan Parduzi ka qenë, stomakun e ka pas krejt të
21 qitur jashtë. Ashtu edhe Nura ka qenë i plagosur në stomak
22 kështu edhe në kurriz, tek qafa.

23 Py. Më përpara na thatë që shkuat ta vizitoni edhe me shiku a
24 ka nevojë për ndonjë ndihmë?

25 Pë. Saktë.

1 Py. A patët nevojë ju me i ofru ndonjë ndihmë?

2 Pë. Ne nuk kishim mundësi me i ofru ndihmë për ato momente,
3 se s'kishim barna. Me do fasha kush ka mund me i lidh ato
4 varrë. Edhe unë jam angazhuar për me ba një transport, me i çu
5 në ndonjë spital.

6 Py. Z. Dëshmitar, a e kërkoi dikush nga ju, që ju me e ba atë
7 transport?

8 Pë. Jo. Unë vullnetarisht.

9 Py. A e dinit ju se ku duhet me i çu, ku është ai spital?

10 Pë. Jo. Nuk e dinim. Por e vetmja rrugë qe ishte, ishte nga
11 Koliqi andej diku nga Sharbani me dalë. Se në atë pjesën andej
12 ishte e pamundshme, se ishte një bllokadë totale nga forcat
13 serbe. Prej Lupçit deri në Popovë, gjithë rrafshi rrugor ka
14 qenë i bllokuar prej forcave serbe. Edhe ajo popullatë ka qenë
15 diku 80-100 mijë dhe mendoj që ka qenë një kamp, në atë kohë.
16 Se Llapi ka qenë i shprazur komplet nga popullata. Vetëm
17 forcat serbe kanë manipuluar në atë pjesën andej.

18 Py. E përmendët fshatin Popovë. Pse e përmendët fshatin
19 Popovë?

20 Pë. E thashë, prej Popove e krejt ajo popullatë ka kaluar në
21 pjesën tonë, në territorin e Gollakut, duke filluar prej
22 Surdullit, Herticë, Turiqicë, Drazhnje, Orllan, Rakinicë,
23 Muhazob. Në krejt atë pjesën e Gollakut, popullata e Llapit
24 është tërhequr nga lufta ka ardhur tek ne.

25 Py. Z. Dëshmitar, kur u pa nevoja që duhet Nuredin Ibishi dhe

1 Kapllan Parduzi të transportohen diku tjetër ku do të ketë
2 kushte për trajtim më të mirë të tyre mjekësor, çka vepruat
3 ju?

4 Pë. Gjatë asaj kohe, se krejt popullata shqiptare që ishte në
5 lëvizje, edhe familja ime ishte e përgatitur për lëvizje.

6 Gjithë shqiptarët i përgatitën makineri çka kishin, traktorë
7 kuaj, me najlon, me ushqim, aq ushqim sa kishim, për tërheqje
8 nga forcat serbe, ashtu edhe unë e përgatita traktorin tim. Me
9 najlon, me ushqime, me veshmbathje me ato sa i kishim.

10 Dhe kur e dëgjova lajmin dhe i pashë bashkëfshatarët e mi
11 dhe luftëtarët e plagosur, shkova i tërhoqa të gjitha sendet
12 nga traktori dhe shkova i mora ata. Jena nis nga fshati
13 Turiqicë, kemi ba deri tek Sharbani 48 orë transport.

14 Py. Z. Dëshmitar, a ju ndihmoi dikush që Nuredin Ibishin dhe
15 Kapllan Parduizin t'i vendosnit në traktor?

16 Pë. Po. Ka pas popullatë shumë. Unë nuk mund me cek me emra
17 kush i ka ndihmu prej atij spitalit të improvizuar, deri në
18 prikolicën e traktorit tim. Se unë kam qenë i përcaktuar në
19 vozitje. Me sa di unë dhe më kujtohet mua, ka qenë Nura,
20 Kapllani edhe një doktor, deri në fshatin Rakinicë. Prej
21 fshatit Rakinicë ne jemi në lartësinë mbidetare mbi 680-700
22 metra, është lartësia mbidetare. Nuk kena pas mundësi me shku
23 rrugëve, kena kalu rrugëve të pyllit. Atëherë kanë ardhur dhe
24 2 persona të tjerë me nga një traktor, na kanë tërheqë neve.
25 Do të thotë, tre traktorë. Unë me të plagosurit edhe dy

1 traktorë të tjerë para meje.

2 Py. Sa larg është fshati Turiqicë prej fshatit Rakinicë?

3 Pë. Në vijë ajrore është 4 kilometra, por ne i kemi ra

4 rrugëve të tjera që kanë qenë shumë më larg.

5 Py. Në momentin kur erdhën këta dy personat për me ju ndihmu,

6 a i keni njohur ju këta dy personat?

7 Pë. Po.

8 Py. A mund të na tregoni kush janë?

9 Pë. Po. Ka qenë Rrahman Zeka dhe Sabit Rrahimi.

10 Py. Dhe nga fshati Rakinicë vazhduat rrugën për ku?

11 Pë. Prej fshatit Rakinicë kena kalue në fshatin Mazap. Prej

12 Mazap kena kalu në fshatin Bllatë. Prej fshatit Bllatë kena

13 kalu në Kalaticë. Prej fshatit Kalaticë kena kalu në fshatin

14 Krushevicë. Prej Krushevice kena kalu në fshatin Ballaban.

15 Prej fshatit Ballaban kena kalu në drejtim të fshatit Koliq.

16 Dhe prej Koliqi në drejtim të Sharbanit. Nga Sharbani në

17 Rimanishtë.

18 Py. Gjatë tërë këtij rrugëtimi, a jeni ndal, a keni pas

19 nevojë për pushim?

20 Pë. Vetëm në një rast jena ndal. Një person, nuk e di si e

21 quajnë, se unë vetëm kam vozitur traktorin edhe gjatë gjithë

22 asaj kohe vetëm shi ka ra. Edhe unë vetëm me traktorin jam

23 marrë. Një person ka thënë, "Ndale traktorin se po vdes

24 Kapllan Parduzi".

25 Një orë kemi pauzu në shi deri sa e kanë trajtuar me një

1 infuzion, mund me e quajt a diçka po se s'e kam pa. Se

2 asnjëherë nuk kena pauzu.

3 Py. Gjatë këtij rrugëtimi prej fshatit Turiqicë deri në

4 Rimanishtë, a ka qenë edhe dikush tjetër që ju ka përcjellë?

5 Pë. Prej fshatit Turiqicë, veç një segment është, prej

6 fshatit Turiqicë deri në fshatin Krushevicë, më kanë përcjellë

7 dy traktorët, Rrahman Zeka dhe Sabit Rrahimi. Nga fshati

8 Krushevicë andej deri në fshatin Koliq kam udhëtuar vetëm.

9 Py. Dhe prej fshatit Koliq deri në fshatin Rimanishtë?

10 Pë. Po. Kanë qenë dy persona të cilët janë ardhë. Unë nuk e

11 di as informata qysh ka ndodhë. Na kanë përcjellë dy persona

12 me një traktor para nesh, në një largësi deri diku 200 metra

13 larg nesh. Për shkaqe të sigurisë a ku ta di unë, të rrugës.

14 Para nesh kanë ec ato me traktor duke na përcjell rrugën deri

15 në fshatin Rimanishtë.

16 Py. A i keni njohur këta dy persona?

17 Pë. Jo.

18 Py. Po këta dy persona, kanë qenë civilë?

19 Pë. Civilë.

20 Py. Gjatë krejt këtij rrugëtimi dhe kur keni mbërrir në

21 Rimanishtë, a keni pas kontakt me këta dy persona?

22 Pë. Jo, absolut.

23 Py. Këta dy persona, a kanë pas mundësi me u afru dhe me

24 bisedu me Rrahman Dinin dhe -- më falni, me Kapllan Parduzin

25 dhe Nuredin Ibishin?

1 Pë. Një moment, me sa më duket mua tash nuk jam i sigurt në
2 cilën pjesë, se deri në Koliq e kam njohur atë territor. Në
3 Koliq e andej, unë nuk e kam njohur territorin. Jena ndal unë
4 me krye për nevoja personale të mijat. Me sa më duket u ndal
5 edhe traktori. Edhe traktori para nesh ka qenë, nuk mund me
6 thanë që me ta vërtetu as po as -- se s'e kam pa. Veç atë
7 periudhë -- krejt ngjarja, atë periudhë nuk di me të tregu.
8 S'jam i sigurt. Po me sa më duket mua, po. Aty ka qenë krejt
9 dy minuta kohë.

10 Py. Po gjatë këtij rrugëtimi, a keni dëgjuar qe janë thirr
11 mes veti?

12 Pë. Jo, s'kam mund me ndigju. Se unë kam qenë në traktor
13 përpara, rimorkio përmbas ka qenë e mbuluar. Nuk kam mund me
14 ndigju gjësend. Edhe ka ra shi tërë kohën.

15 Py. Kur keni mbërrit në fshatit Rimanishtë, çka ka ndodhë
16 pastaj?

17 Pë. Në fshatin Rimanishtë, mbas 48 orëve ne kemi mbërrit nga
18 ora 8.15 e mbrëmjes. Se kjo ngjarje ka ndodhur më 10 prill. Ne
19 tërë natën, kena udhëtu tërë ditës, në mbrëmje kena mbërrit.
20 48 orë ne kena ba rrugë deri në Rimanishtë. Në Rimanishtë kam
21 mbërrit nga ora 8.15, 8 e diçka.

22 Py. Edhe a keni vazhdu ju -- aty jeni ndal, nuk keni vazhdu
23 ma kurrkund?

24 Pë. Aty jena ndal ne. Aty e kam përfundue misionin.

25 Py. Ti prej Rimanishtës, a je kthy përsëri në fshatin tënd?

1 Pë. Përsëri në fshatin tim jam kthye.

2 Py. E, a e din çka ka ndodhë me Nuredin Ibishin dhe Kapllan
3 Parduzin?

4 Pë. Nuk e di çka ka ndodhë. Vetëm di që në xhip, me sa më
5 duket mua, se është problem me përcaktu se s'ka pas rrymë ka
6 qenë kohë e errët. Ata dy personat Nura dhe Korabi, ka qenë
7 një xhip i vogël Mitsubishi, ju kanë mbet këmbët jashtë gepekut
8 zhag. Edhe nuk e di ma mandej çka ka ndodhë.

9 Py. Kur i kanë vendos në xhip, a keni shku ju ma përpara apo
10 xhipi ka shku ma përpara?

11 Pë. Mund me qenë barabartë kena mbërrit në atë vend. Tash nuk
12 mund ta di se, thashë, ka qenë kohë lufte ka qenë terr. S'ka
13 pas rrymë. Me do drita shkrepësesh ne mundoheshim me ba
14 ndriçim.

15 Py. E kur u nisët prej fshatit Rimanishtë për me u kthy në
16 Orllan, ju a jeni nis para se me u nis xhipi, apo?

17 Pë. Jo, jo. Në fshatin Rimanishtë unë kam qëndru tek një
18 person i panjohur, një plak. Atë natë kam bujtur në
19 Rimanishtë. Ata janë nis një rrugë që unë nuk e di nga kanë
20 shku.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Avokat Mbrojtës, z. Dëshmitar, ngadalësoni pak kur
23 përgjigjeni. Bëje atë pushimin. Pra, mbasi mbaron z. Shala
24 pyetjen, merr frymë thellë dhe pastaj përgjigju.

25 Ju lutem vazhdoni, pala Mbrojtëse.

1 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, me lejen tuaj
2 do t'i kërkoja Sekretarit të Gjykatës të shfaqë në ekran
3 dokumentin DSM00778, si dhe dokumentin DSM00090. Dokumenti i
4 dytë është në anglisht, është deklarata e dëshmitarit që i ka
5 dhënë Mbrojtjes. Ndërsa dokumenti i parë 778, është dokument
6 në gjuhën shqipe.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj
8 se doni të ballafaqoni dëshmitarin me?

9 Z. SHALA: [Përkthim] Deklaratën që i ka dhënë Mbrojtjes.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbi
11 aspektet për të cilat dëshmitari sapo na foli, na dha
12 dëshminë.

13 Ju lutem vazhdoni, Sekretar i Gjykatës.

14 Z. SHALA: [Përkthim] Ju lutem Sekretar i Gjykatës,
15 dokumenti DSM00782, faqja 5 si dhe dokumenti DSM00095, faqja
16 6.

17 Py. Z. Dëshmitar, a jeni duke i parë në ekran, dy dokumente
18 janë.

19 Pë. Po.

20 Py. Dokumenti në anën e majtë është në gjuhën shqipe, ndërkaq
21 dokumenti në anën e djathtë është në gjuhën anglishte.

22 Z. SHALA: [Përkthim] Z. Sekretar i Gjykatës, në se mund
23 të shkoni deri në fund të faqes në versionin e shqipes, ju
24 lutem. Faleminderit.

25 Py. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që Mbrojtjes së Salih

1 Mustafës i keni dhënë deklaratë?

2 Pë. Po.

3 Py. Në pyetjen e Avokatit Mbrojtës, "A i dini emrat e tyre",
4 ju jeni përgjigjur:

5 "Nuk mbaj mend, por të paktën dy herë njerëzit thirrnin
6 emrin Cali, Cali".

7 A ju kujtohet që keni deklaruar kështu?

8 Pë. Po.

9 Py. A mund të na tregoni e keni dëgjuar emrin Cali, Calu?

10 Pë. Tash, deri në Koliq, nuk jam i sigurt saktë si quhet
11 vendi, veç dy persona në fillim kanë ardh me traktor. Për mua
12 janë të panjofshëm. Atëherë kam thonë e prapë po them. Me sa
13 më kujtohet e ka thënë, "Cal, a të shkojmë në të djathtë, apo
14 në të majtë". Kaq. Edhe unë ma me ato persona nuk jam taku.

15 Py. A keni pas mundësi ju me i pa fizikisht këta dy persona?

16 Pë. Fizikisht thashë, kam pas mundësi në distancë. Po.

17 Py. Dhe në qoftë se këta dy persona i shihnit ma vonë, a e
18 kishit pas mundësinë me i identifiku?

19 Pë. Ka mundësi me i identifiku.

20 Py. Në muajin prill të vitit 1999 për ngjarjen që jemi duke
21 folur, a e keni njohur Salih Mustafën.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Prisni. Pala Mbrojtëse, e dëgjova mirë? E dëgjova vitin 1998,
24 por thatë 1999. Më falni. Më falni që ju ndërpreva.

25 Z. SHALA:

1 Py. A e keni njohur Salih Mustafën në muajin prill të vitit
2 1999?

3 Pë. Për fat të keq timin, nuk e kam njohur.

4 Py. Sot, a e njihni Salih Mustafën?

5 Pë. Nuk e kam pa kurrë deri në televizor kur e kam pa.

6 Py. A e dini Salih Mustafa ka nofkë, a e thërrasin edhe
7 ndryshe?

8 Pë. Kam dëgjuar përmes televizorit mbasi që u bë publike ajo
9 arrestimi i tij. Atëherë e kam kuptu edhe e kam kuptu që e ka
10 nofkën Cali. Jo, s'e kam dëgju përpara.

11 Py. Atë personin Cali që e keni pa gjatë rrugëtimit nga
12 fshati Turiqicë deri në fshatin Rimanishtë, nga kujtesa e
13 juaj, a mund të jetë Salih Mustafa ai person?

14 Pë. Po janë ba 23 vite, është pak problem se ka ndryshue. 23
15 vite janë shumë. Nuk mundem me përcaktu saktë, po këtu nuk kam
16 përgjigje.

17 Py. Faleminderit.

18 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, me lejen tuaj
19 do t'i lutesha Sekretarit të Gjykatës të vendosë në ekran
20 dokumentin DSM00099. Është një hartë. Thjesht dua që
21 dëshmitari të na tregojë rrugën që ka ndjekur nga fshati
22 Turiqicë deri në fshatin Rimanishtë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
24 lutem vazhdoni, Sekretar i Gjykatës.

25 Z. SHALA:

1 Py. Z. Dëshmitar, a jeni duke e parë në ekran një dokument,
2 një hartë?

3 Pë. Po.

4 Py. Në pjesën e poshtme të kësaj harte është shkrimi, emri
5 juaj dhe një nënshkrim dhe data. A është shkrimi dhe
6 nënshkrimi juaj ky?

7 Pë. Po

8 Py. Në këtë hartë kemi disa numra prej numrit 1 deri në
9 numrin 9. Dhe poshtë secilit numër janë të rrumbullakuara
10 emërtimet e vendbanimeve. A i kini vendos këto shenja ju
11 personalisht në këtë hartë?

12 Pë. Po.

13 Py. Çka keni dash me tregu me vendosjen e numrave dhe me
14 rrumbullakimin e vendbanimeve në këtë hartë?

15 Pë. Kjo është rrugëtimi të cilën e kena ba.

16 Py. A mundeni edhe njëherë të na i tregoni të gjitha këto
17 fshatrat që i keni rrumbullakosur?

18 Pë. Po. Nga fshati Turiqicë kena kalu në fshatin Rakinicë.
19 Nga fshati Rakinicë kena kalu në fshatin Bllatë. Nga Bllata
20 kena kalu në Kalaticë. Nga Kalatica kena kalu në fshatin
21 Krushevicë. Nga fshati Krushevicë kena kalu në fshatin
22 Ballaban. Prej fshatit Ballaban kena kalu në fshatin Koliq.
23 Nga fshati Koliq kena kalu në fshatin Sharban. Dhe nga
24 Sharbani në Rimanishtë.

25 Py. Faleminderit Z. Dëshmitar. Pas kësaj ngjarje të muajit

1 prill të vitit 1999, a jeni takuar ma me Nuredin Ibishin dhe
2 Kapllan Parduzin?

3 Pë. Me Nuren jam takuar.

4 Py. A mund të na tregoni, kur jeni takuar për herë të parë
5 mbas kësaj ngjarje? Nëse ju kujtohet?

6 Pë. Mbas nja dy muajsh me sa duket. Se ai ka qenë në shërim.
7 Me Nuren jam taku mbas 2 muajsh. Për një Bajram, me sa më
8 duket mua ka qenë. Me ba Bajram. Për festë të Bajramit.

9 Py. Thatë ka qenë në shërim. A e dini ku ka qenë në shërim?

10 Pë. Jo.

11 Py. Q'atëherë kur jeni takuar, a e keni diskutuar ngjarjen,
12 rrjedhat e kësaj ngjarje, të prillit të vitit 1999?

13 Pë. Jo. Nuk kem nevojë me e diskutu se boll kemi trauma. Unë
14 personalisht nuk dua me hy në ato biseda, se janë biseda të
15 rënda. S'kam nevojë me ngarku kryet.

16 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, më duhet një
17 minutë të konsultohem me ekipin.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull. Vazhdoni ju lutem

20 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

21 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk kemi pyetje
22 të tjera për dëshmitarin. Faleminderit.

23 Py. Z. Dëshmitar, Mbrojtja nuk ma pyetje. Faleminderit shumë.

24 Pë. Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Z. Prokuror, tani është radha juaj. A jeni gati të
3 filloni me kundra pyetjet, apo dëshironi nja pushim prej
4 gjysmë ore?

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse. Do të na
6 ndihmonte pak kohë për të marrë disa nga referencat në
7 transkript. Por mund ta vendosni ju.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Atëherë, bëjmë gjysmë ore pushim, pak më herët nga sa e bëjmë
10 zakonisht. Por është krejt normale për ta bërë, sepse mbaruam
11 me pyetjet e drejtpërdrejta nga pala Mbrojtëse.

12 Z. Dëshmitar, si do të veprojmë tani, është si në vijim.
13 Do të bëjmë nja pushim 30 minuta dhe pastaj përfaqësuesi i
14 Prokurorisë së Specializuar do të bëj kundra pyetjet. Do ju
15 bëj pyetje Prokuroria tashmë. Në rregull?

16 DËSHMITARI: Në rregull.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
18 Asistente e sallës do ju shoqërojë jashtë sallës së Gjyqit.
19 Faleminderit.

20 DËSHMITARI: Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit znj. Asistente.

24 Do të takohemi në orën 10.50.

25 Seanca ndërpritet.

1 --- Pauza fillon në orën 10.19

2 --- Seanca rifillon në orën 10.50

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vërej
4 që jemi në të njëjtën përbërje. Mund të vijojmë.

5 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem sillni dëshmitarin në
6 sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
9 se erdhët përsëri z. Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: Mirë se ju gjej.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
12 do ia jap fjalën Zyrës së Prokurorit të Specializuar për
13 kundrapyetjet.

14 Z. Prokuror, fjala është për ju.

15 Z. DE MINICIS: Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

16 Pyetje vijuese z. De Minicis:

17 Py. Mirëmëngjesi z. Rrahimi.

18 Pë. Mirëmëngjesi.

19 Py. Sot dëshmuat se në kohën që çuat Nuredin Ibishin dhe z.

20 Parduzi nga Turiqica drejt Rimanishtes, ju nuk e njihnit Salih
21 Mustafën, kështu apo jo?

22 Pë. Po.

23 Py. Në fakt nuk e kishit dëgjuar asnjëherë, deri kur e patë
24 në televizor pas lufte apo jo?

25 Pë. Po.

1 Py. Po ashtu thatë se nuk ia dinit nofkën që është Cali, që
2 është diçka që po ashtu e morët vesh pas lufte kur e patë në
3 televizion. A e kuptuam kështu?

4 Pë. Po.

5 Py. Pra me të drejtë mund të themi që natën që emri Cali -
6 emrin që keni dëgjuar Cali nuk kishte ndonjë rëndësi për ju.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
8 lutem riformulojeni pyetjen, sepse diçka po nënkuptoni. Ju
9 lutem riformulojeni pyetjen.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni.

11 Py. Pra Calin asokohe, a ishte ndonjë emër me ndonjë farë
12 rëndësie për ju? A ishte ndonjë emër - pra natën që e dëgjuat
13 që po shoqëronit të plagosurit, emri Cali a kishte ndonjë
14 kurrfarë rëndësie për ju?

15 Pë. Absolut kurrfarë rëndësie s'ka pasë për mu.

16 Py. Megjithatë 23 vite më vonë që u përmend edhe sot, po
17 pastaj 23 vitesh, ju kujtoni, e kujtoni që dikush, që ju
18 s'jeni i sigurt kush ishte thirri, "Cali," e përmendi "Cali,"
19 "Cali,". Kështu thatë në dëshminë e sotme, dikush që s'e
20 njihnit përmendi "Cali," "Cali," apo jo?

21 Pë. Po.

22 Py. Po ju pyes, ka qenë para 23 vitesh. Thjesht duam të
23 verifikojmë a jeni i sigurt. Po ju jeni i sigurt që e mbani
24 mend këtë emër?

25 Pë. Po.

1 Py. Ju thatë se po binte shi; apo jo?

2 Pë. Po.

3 Py. Ju po ngisnit, po vozisnit një traktor; apo jo?

4 Pë. Po.

5 Py. Dhe ishte një traktor tjetër para jush?

6 Pë. Deri në Koliq, jo një traktor, po dy traktora.

7 Py. Pra kur ju dëgjuat këtë emrin, me sa kuptoj unë dy
8 persona erdhën më pas edhe ata po vozitnin traktorë. Pra ishte
9 traktori juaj dhe një traktor para jush?

10 Pë. Deri në Koliq, të thashë, deri në pjesë të Koliqit më
11 kanë përcjellë Rrahman Zeka dhe Sabit Rrahimi me nga një
12 traktor, gjithsej jena kanë tre traktora.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
14 Dëshmitar, a mund ta përsërisni dhe njëherë përgjigjen se nuk
15 e kuptoi përkthyesi tamam? Mund ta përsërisni edhe njëherë
16 përgjigjen?

17 DËSHMITARI: Po. Deri në një pjesë të Koliqit më ka
18 përcjellë Sabit Rrahimi dhe Rrahman Zeka me një traktor.
19 Rrahmani një traktor, Sabiti një traktor, domethënë dy
20 traktora. Gjithsej kam dy traktora para meje.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

22 Py. E kuptoj. Atëherë në Koliq, aty afër Koliqit ju thatë se
23 dy persona të tjerë me rroba civile që nuk i njihnit, po ashtu
24 i shoqëruan grupit tuaj, apo jo?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Prokuror, a mund të na thoni dhe referencat e transkriptit se
2 kështu veprojmë zakonisht.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është faqja 17:

4 "Deri në Koliq, nuk jam i sigurt si quhet ai vendi po di
5 që erdhën dy persona të tjera me traktorë, në traktorë më
6 falni, në traktorë. Nuk i njihja këta persona."

7 Py. Në atë moment, kur këta dy personat mbërritën në Koliq, a
8 ishte në traktorin, a erdhën në traktorin tuaj këta personat e
9 rinj? Dhe a ishin larguar traktorët e tjerë në atë moment?

10 Pë. Dy traktorat në momentin që kanë ardhë që ky traktori që
11 po kërkon ti me këta dy personat kanë qenë në një traktor.
12 Gjatë asaj kohe, unë jam konë vetëm në traktor.

13 Py. Në rregull.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si e
15 kuptoj unë. Se edhe unë po ngatërrohem me fjalën traktor
16 shumë. Si e kuptoj unë: dy traktorët që ishin atje më përpara,
17 ishin pra dy, çfarë ndodhi me ata dy traktorët që përmendëm që
18 ishin në fillim me ty? Çfarë ndodhi me këta traktorë?

19 DËSHMITARI: Ata janë kthy mbrapsht.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Po ia kaloj fjalën z. Prokuror.

22 Po ju lutem kini parasysh, dua pak qartësim sesa traktorë
23 kanë qenë, kur dhe ku, kur dhe ku kanë qenë.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirë.

25 Py. Z. Dëshmitar, ju na thatë që u nisët nga Turiqica me

Dëshmitari: Sheqir Rrahimi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 27

1 traktorin tënd dhe me rimorkion që kishte të plagosurit apo

2 jo?

3 Pë. Po.

4 Py. Dhe me ty në traktor ishte dhe një doktor, një mjek apo

5 jo?

6 Pë. Po.

7 Py. Në një moment në kohë, në një pikë kohore, një traktor

8 tjetër u bashkua me ju dhe ju përmendët edhe personat që, dy

9 personat që ndodheshin në traktor që i njihnit. Thatë që i

10 njihnit. E keni thënë edhe në deklaratë që tashmë kanë vdekur

11 fatkeqësisht. Por ata në një moment, në një moment u bëtë pra

12 dy traktorë. Pra siç po e kuptoj unë ishte traktori i

13 dëshmitarit me rimorkio dhe pastaj një traktor me dy persona.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Propozoj ta pyesni ju dëshmitarin nëse ata, ata dy zotërinj,

16 ata dy ishin në një traktor apo në dy traktorë, sepse ne e

17 kemi kuptuar ndryshe.

18 Ju lutem z. Dëshmitar.

19 DËSHMITARI: Dy persona kanë qenë me nga një traktor.

20 Gjegjësisht dy traktora, dy persona.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra

23 kemi tre traktorë. Flasim për tre traktorë.

24 DËSHMITARI: Tre traktorë.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull. Tre traktorë.

1 Py. Momentin që arritët në Koliq dhe kur erdhën dhe këta dy
2 persona me traktorët e tyre, ju thatë që ata dy të parët u
3 kthyen.

4 Pë. E saktë.

5 Py. Në rregull. Besoj se e sqaruar këtë që kishte dy traktorë
6 që u larguan pra në këtë pikë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Dëshmitar, a mund t'i hiqni pak dëgjueset ju lutem.

9 Sa e kuptoj unë është që kemi një traktor me rimorkio ku
10 ishte pra dëshmitari ynë. Dhe tani do të diskutojmë traktorët
11 e tjerë me dy persona të tjerë në atë traktor, kjo është.

12 Ju lutem vazhdoni atëherë z. Prokuror.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

14 Py. Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit, z. Dëshmitar.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

18 Py. Kur Avokati i Mbrojtjes ju pyeti sot nëse ishit në
19 gjendje t'i dëgjonit njerëzit që ndodheshin në atë traktor
20 duke folur njëri me tjetrin, ju thatë -

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe kjo gjendet në faqen 17, të
22 nderuar Gjykatës.

23 "Jo, nuk i dëgjova kur flisnin njëri me tjetrin. Isha në
24 traktor në pjesën e përparme. Rimorkio ishte e mbuluar kështu
25 që unë nuk isha në gjendje të dëgjoja asgjë."

1 A ju kujtohet që e keni thënë një gjë të tillë?

2 Pë. Nuk kuptova.

3 Py. Sot Avokati i Mbrojtjes pyeti nëse ishit në gjendje t'i
4 dëgjonit këta njerëz kur arritën në Koliq. Ai të pyeti nëse
5 ishe në gjendje t'i dëgjoje kur flisnin me njëri-tjetrin. Dhe
6 ju u përgjigjët:

7 "Jo, unë nuk i dëgjova duke folur njëri me tjetrin. Unë
8 isha në pjesën e përparme të traktorit. Rimorkio prapa ishte e
9 mbuluar. Kështu që ishte e pamundur që unë të dëgjoja ndonjë
10 gjë."

11 A ju kujtohet që e keni thënë një gjë të tillë?

12 Pë. E saktë është q'ashtu.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, z. Prokuror.

15 Avokati i Mbrojtjes, ju do ta keni të drejtën e fjalës,
16 nëse e keni fjalën për referencën.

17 Z. SHALA: Po është në faqen 13. Dhe pyetja kishte të
18 bënte me Nuredin Ibishin dhe Kapllan Parduzin dhe jo me dy
19 personat të cilët erdhën me traktorin e ri. Unë nuk e kam bërë
20 këtë pyetje dhe nuk kam marrë përgjigje për atë pyetje siç
21 pretendon Prokurori.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit për komentin tuaj.

24 Z. Dëshmitar, a mund t'i hiqni dëgjueset ju lutem.

25 Z. Prokuror, unë kisha një koment pak më të ndryshëm për

1 të bërë. Pyetja që po bëni ju nuk është në faqen 17, pasi në
2 faqen 17 lexohet pjesa "Cali, Cali". Në faqen 14 është bërë
3 një pyetje e afërt me atë që ju po i bëni dëshmitarit. Po nuk
4 ka të bëjë me këta dy dëshmitarët, me këta dy personat e rinj.
5 Por më duhet ta rilexoj edhe njëherë, por ajo që thotë Avokati
6 i Mbrojtjes duhet mbajtur parasysht, prandaj unë do t'ju
7 kërkoja juve që tregoheni më preciz kur jepni referencat
8 tuaja.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e kuptoj se çfarë shkruhet në
10 faqen 27, në rreshtin 1.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
12 është kjo një temë e ndryshme? A është kjo një temë e
13 ndryshme?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, është e ndryshme.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
16 një çështje e ndryshme dhe do duam t'i ndajmë njëra nga
17 tjetra, ta bëjmë pak më vonë. Të përfundojmë njëherë me këtë
18 temë që po diskutojmë, këtë çështje që po diskutojmë dhe
19 pastaj.

20 Prokuror, a doni pak kohë?

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për këtë jo, jam i gatshëm.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
23 të mbani parasysht dy komente që kemi bërë ne të dy edhe pala
24 Mbrojtëse edhe ne.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që e kam

1 cituar gabimisht këtë pjesë. Avokati i Mbrojtjes kishte të
2 drejtë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
4 i kthehem edhe njëherë palës Mbrojtëse. Ju thatë rreshti 27?

5 Z. Avokat, më kanë konfirmuar që do ta dëgjojnë edhe
6 njëherë atë pjesë dhe do të korrigjohet. Dakord.

7 Z. Prokuror, e keni fjalën edhe njëherë.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ajo që po përmendja më herët
9 dhe për të cilën kishte të drejtë Avokati Mbrojtës, ishte për
10 këta dy persona të cilët ishin në rimorkio prapa dhe jo duke
11 folur njëri me tjetrin.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
13 kuptoj, e kuptoj, por dëshmitari i ka vendosur dëgjueset.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
15 Py. Dua të kuptoj ku ishte ti kur këta dy persona janë ofruar
16 tek traktori yt. Ku ishte ti në atë kohë? Pasi është paksa e
17 paqartë kjo përgjigje në transkript.

18 Në faqen 13 Avokati Mbrojtës, ju ka pyetur.

19 "Gjatë këtij udhëtimi pasi kishit arritur në Rimanishte,
20 a keni patur kontakt me këta dy persona?"

21 Dhe ju thatë:

22 "Jo, absolutisht jo."

23 Dhe më pas Avokati ju pyeti:

24 "Këta dy persona a ishte e mundur që ata t'i afroreshin
25 Kapllan Parduzit dhe Nuredin Ibishit për të biseduar me ta?"

1 Dhe ju u përgjigjët:

2 "Në një moment të caktuar, në një pikë të udhëtimit në
3 afërsi të Koliqit, unë e kam njohur atë zonë. Pas Koliqit nuk
4 e kam njohur. Kështu që ne ndaluan për nevoja personale. Unë
5 isha në traktorin në krye, por nuk mund të them nëse e kam
6 parë atë apo jo. Por nuk e njoh këtë segment të udhëtimit. Nuk
7 më kujtohet. Por mesa më kujtohet nuk ka zgjatur më shumë sesa
8 dy minuta."

9 Këta dy persona a janë afruar ata tek rimorkio ku ishte
10 Kapllan Parduzi dhe Nuredin Ibishi, apo jo?

11 Pë. Po. Thashë unë për dy minuta.

12 Py. Ku ishte ti kur ata u afruan tek Kapllan Parduzi dhe
13 Nuredin Ibishi?

14 Pë. Unë edhe më herët e ceka, për nevoja personale të miat dy
15 minuta jam ndalë. U ndal traktori. Dhe gjatë asaj pauzës kam
16 mujt me bisedu që ato dy minuta. Ma shumë jo se s'kena pasë
17 kohë na me u ndal edhe me bisedu - se ishte në pyetje jetë a
18 vdekje.

19 Py. Pra ata kanë patur mundësi që të afroreshin për të folur
20 me ta. A i keni parë ata kur janë afruar tek rimorkio ku ishte
21 Kapllan Parduzi dhe Nuredin Ibishi? A i ke parë pra këta dy
22 persona kur janë afruar tek rimorkio?

23 Pë. Një person e kam pa, dy s'muj me thonë. Për një, po.

24 Kështu që si bliz më duket se u taku.

25 Py. Pra ti zbritte nga traktori dhe shkove për nevojat e tua

1 personale. Në sa distancë larg ke shkuar? Sa je larguar? Sa
2 ishte distanca?

3 Pë. 10-15 metra.

4 Py. Pra kur keni kryer nevojat tuaja personale, e kishit
5 shpinën të kthyer nga traktori apo jo?

6 Pë. Normal.

7 Py. Pra mund të thuhet thjesht që në atë kohë ti nuk i kishe
8 sytë në drejtim të traktorit apo jo?

9 Pë. Jo.

10 Py. Atëherë keni përfunduar nevojat tuaja personale, jeni
11 kthyer, keni shkuar tek traktori, kështu është?

12 Pë. Po.

13 Py. Dhe tani po thoni që keni parë një person atje. Kjo ju
14 kujtohet?

15 Pë. Thashë këta, traktori prej Koliqi, traktori që dalë
16 civilët me na përcjellë janë konë dy. Me sa më duket mu,
17 thashë, një person ka mujt me shku tek traktori, te rimorkio.
18 Ajo ka zgjatë dy minuta, që ajo pauzë.

19 Py. Këtu jam paksa i hutuar pasi ju i thatë palës Mbrojtëse
20 se - në një pikë ju thatë që, me sa më kujtohet ishin dy
21 persona. Dhe besoj se është në faqen 17.

22 "...njëri e pyeti tjetrin 'Cali, të shkojmë në të majtë
23 apo në të djathtë?'"

24 Ndërsa tani po thoni që bëhet fjalë për një person të
25 vetëm, i cili është afruar tek traktori yt dhe jo dy persona.

1 Pyetja që kam është, a i ke dëgjuar vërtet dy persona
2 njëri nga të cilët thoshte "Cali, a të kthehemi në të djathtë
3 apo në të majtë," ndërkohë që binte shi, ndërkohë që traktori
4 ishte i ndezur?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
6 të bëj një koment. Po shoh që ka ngritur dorën edhe
7 dëshmitari.

8 Z. Dëshmitar, çfarë doni të thoni?

9 DËSHMITARI: Po du me sqaru edhe njëherë se unë po thom
10 ndryshe, ai po e kupton ndryshe po më duket mu. Unë po thom
11 ato ca u konë. Që don ky me i thonë ça don, unë nuk muj me i
12 thonë. Unë e thashë fillimisht, traktori deri në Koliq na kanë
13 përcjellë dy traktora deri në një pjesë të Koliqit, dy,
14 Rrahman Zeka dhe Sabit Rrahimi. Në atë pjesën e Koliqit është
15 terren pak më i butë se pjesa kah kemi shku. Ata janë kthi në
16 shpi.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
18 çfarë ndodhi më pas, pasi edhe unë nuk e kuptoj shumë mirë.
19 Kështu që do të isha shumë e lumtur po të na e sqaroje edhe
20 pak më shumë.

21 DËSHMITARI: Saktë. Që tash.

22 Në atë moment ka ardhë një traktor me dy persona.
23 Traktori dhe dy njerëz. Gjatë rrugëtimit veç tu ec se s'kena
24 pasë kohë na bisedu edhe me u përshëndet me njerëz se ish kohë
25 lufte, gjendje e rëndë e dy pacientë aty, Nuredin Ibishi dhe

1 Kapllan Parduzi. Në q'atë moment, një person e këtë vetë?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Dëshmitar.

4 DËSHMITARI: E ka pyet me sa më duket edhe s'muj me
5 paramendu, "Cali, a me shku në të djathtë apo në të majtë?"

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Personi që ka bërë këtë pyetje, a ishte ky njëri nga dy
8 personat që erdhën me traktorin tjetër?

9 DËSHMITARI: Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Pyetjet që po ju bën Prokurori kanë të bëjnë me njërin nga
12 personat, të cilët i kanë afruar traktorit të dëshmitarit. A
13 doni të vazhdoni t'i bëni pyetje, pasi nuk dua t'i marr unë
14 përsipër të bëj pyetjet tua në këtë pikë?

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk jam i qartë nëse dëshmitari
16 e ka dëgjuar në fakt përdorimin e emrit Cali, Cali. Këtë po
17 kërkoj të gjej.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

19 Dëshmitar, ju lutem a mund t'i hiqni dëgjueset, pasi dua t'i
20 bëj një pyetje Z. Prokuror? Faleminderit.

21 Ju dëgjova që thatë që ishte i ndezur traktori. Këtë nuk
22 e kisha dëgjuar të përmendet si pjesë e pyetje-përgjigjeve.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e nderuara
24 Gjykatëse. Ndoshta do ta pyesja dëshmitarin nëse e kishte
25 fikur traktorin. Ai ka shpjeguar kronologjinë dhe ndoshta do

1 të duhej ta kisha bërë këtë pyetje vetë për ta vërtetuar që ka
2 ndodhur vërtet kështu.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Atëherë duhet të tregoheni më të saktë për shkak se ngrihet në
5 këmbë pala Mbrojtëse dhe thotë se nuk e ka bërë këtë pyetje
6 paraprakisht.

7 Ju e keni fjalën. Mund të vazhdoni.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, a mund ta
9 marr fjalën.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

11 Po pastaj do t'i kërkoj dëshmitarit që të vendosë kufjet.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se ky moment është ajo
13 gjë që për të cilin interesohet pala tjetër atëherë mund ta
14 bëjë këtë pyetje se, kur, në ç'pikë kohore është thënë ajo që
15 është thënë. Mund t'i bëj thjesht një pyetje të hapur. Nuk ka
16 nevojë që ai ta përcaktojë se si ishte situata.

17 [Anëtarët e Trupit Gjygues këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Kolegu im më tregoi që në faqen 33, rreshtat 5 dhe 6,
20 përgjigjja nuk është përkthyer. Kështu që nuk e dimë se çfarë
21 është thënë nga dëshmitari në atë pikë të dëshmisë. Kështu që
22 e bën më të ndërlikuar të vlerësojmë se çfarë ka thënë
23 dëshmitari, pra në atë pikë.

24 Z. Prokuror, mund të vazhdoni. Dhe do të sugjeroja që
25 pyetjet t'i bëni të hapura, por edhe të sakta për ato pyetje

1 që kanë të bëjnë me momentin kur ai kishte dëgjuar çfarë
2 kishte dëgjuar.

3 Dhe siç ndodh edhe kur bëhen pyetjet kryesore, unë
4 përpiqem që të mos ndërhyj shumë me mënyrën sesi bëhen këto
5 pyetje, por ta mbajmë të hapur këtë çështje, pasi duket sikur
6 është një çështje e rëndësishme e kësaj dëshmie.

7 Vazhdoni.

8 Z. Dëshmitar, mund t'i vendosni dëgjueset edhe njëherë.

9 Faleminderit. A më dëgjoni?

10 DËSHMITARI: Po.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Veçse një çast, e nderuar
12 Gjykatëse.

13 Py. Në faqen 13, z. Dëshmitar, ju thatë - avokati ju pyeti në
14 rreshtin 8:

15 "Nga Koliqi në Rimanishte?"

16 Pra po ju pyeste për pjesën e udhëtimit nga Koliqi në
17 Rimanishte.

18 Ju thatë:

19 "Po, ishin dy persona. Kanë ardhur dy persona. Nuk e di
20 si ka ndodhur por kanë ardhur dy persona dhe na kanë
21 shoqëruar. Ata ishin me një traktor përpara nesh, rreth 200
22 metra para nesh, për arsye sigurie, nuk e di."

23 A konfirmoni që këto persona, kur kanë ardhur dhe janë
24 bashkuar me ju ishin në një traktor dhe ky traktor ishte 200
25 metra para jush?

1 Po ju pyes thjesht për të vërtetuar nëse ajo që është
2 regjistruar në procesverbal është vërtet përgjigjja që keni
3 dhënë. Pra ishte traktori 200 metra para traktorit tuaj? Po
4 ose jo është përgjigjja.

5 Pë. Jo, duhet pak me elaborue se ti - unë e kom deklaru
6 ndryshe, ti e ke kuptu ndryshe po më duket mue.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Dëshmitar. Ajo që është shkruar këtu është ekzaktësisht ajo që
9 keni thënë përpara. Avokati nuk është duke i shpikur gjërat
10 është duke cituar ato që ke thënë në mëngjes në përgjigjet
11 tuaja për Avokatin Mbrojtës. Nëse kishit ndërmend të thoni
12 diçka tjetër, mund të shpjegoni, por Prokurori nuk është duke
13 i shpikur gjërat. Nuk është duke i sajuar. Këto janë gjërat të
14 cilat i kemi dëgjuar të gjithë dhe janë të shkruara këtu.
15 Përjashtimi është vetëm në qoftë se është bërë ndonjë gabim. A
16 mund të konfirmoni pra që e keni thënë këtë gjë.

17 DËSHMITARI: Unë muj me thonë në fillim - kanë qenë në një
18 distancë e afërt. Traktori kur u ardhë në tejkalim u zatet
19 edhe veç a në të djathtë a të majtë, Cal, me sa më duket mu,
20 dy herë, Cal a në të djathtë a në të majtë. Tani traktori ka
21 vazhdue rrugën 200 metra para nesh - një distancë veç në
22 transit, është në të djathtë a në të majtë. Traktori ka vazhdu
23 para neve 200 metra për shkakut të sigurisë.

24 Ku ta di unë, nëse jam i qartë.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

1 Py. Tani po. Tani e kuptojmë që ti dëgjove emrin, "Cal, a të
2 shkojmë këtu apo atje?" në kohën kur traktori i tij ishte duke
3 ju parakaluar ju për të shkuar dhe për të ecur 200 metra
4 përpara jush.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Dëshmitar, nuk mjafton për të pohuar me kokë, pasi jo nuk
7 përkthehet por duhet të thoni "po" ose "jo" me gojë.

8 DËSHMITARI: Te ai 200 metërshi te unë është, qysh po e
9 kuptoj unë atë 200 metërshi, transit, afërsisht kur kena bo na
10 me traktora, q'aty i ka thënë, "Cal, nda tash në të majtë." Që
11 aty e kom ndie emrin Cal. Traktori i ka parë ka vazhdu nja 200
12 metra para neve.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
14 s'kuptoj fare.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 Py. Ju thatë - ose dhe me sa kuptojmë ne është që traktori ka
17 ardhë nga mbrapa, ju ka tejkaluar ju, ju ka parakaluar ju dhe
18 pastaj ka ecur 200 metra përpara traktorit tënd për arsye
19 sigurie, kështu është apo jo?

20 Pë. Jo, s'është kështu.

21 Py. [Nuk ka përkthim].

22 Pë. S'kam përkthim.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duhet ta përsëris pyetjen.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
25 pres komentet e zyrës, e kabinës së përkthimit. A po punon

1 përkthimi, a e dëgjon përkthimin?

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Z. Prokuror, përsëriteni pyetjen për të kuptuar se cila
5 ishte pyetja dhe përgjigjja.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

7 Py. Pra në cilën pikë, në cilën kohë pra, e dëgjuat një
8 person që i tha personit tjetër, "Cali do të ecim, të shkojmë
9 në të majtë apo në të djathtë?" Pra, kur saktësisht në kohë e
10 ke dëgjuar.

11 Pë. Po, kohën s'muj ta përcaktoj kështu, diku nga mbrëmja,
12 nga 4 ora mbasdite ka qenë, ose 5. Se s'jam i sigurt, se
13 s'kena pasë as orë.

14 Py. Pra ti ishe me traktorin tënd?

15 Pë. Po, saktë, me traktorin tem. Ai ishte me traktorin e vet.
16 Edhe na kështu. Se di a jam i kjartë. Në transit ka thënë,
17 "Cal, në të djathtë a në të majtë?" Në të djathtë 200 metra ka
18 ecë ai përpara, unë mbas tijna dhe që kaq.

19 S'e di a jam i kjartë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
21 pastaj pyetja ime është: Kur e ke dëgjuar emrin "Cali" që e
22 përdori njëri nga të dy personat që ishin në atë traktor? Kur,
23 në cilin moment?

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Në Koliq.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 kërkoj ndjesë që nuk po jam e qartë. Nuk e kam fjalën për
2 qytetin, për vendin. E kam për momentin kohor, në kohë. Ishte
3 kur? Ata ishin duke ju parakaluar ju, kur ishin para teje apo
4 kur ishin mbrapa traktorit tënd në traktorin e tyre. Kur, në
5 ç'vend, në ç'pikë?

6 DËSHMITARI: Traktori, unë me traktor kështu, ai kështu.
7 Edhe "Cal, në të djathtë a të shmajtë." Që kaq ka qenë ajo. Në
8 të djathtë edhe ec.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit, z. Dëshmitar.

11 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit që e sqaruat.

13 Py. Të dy ju ishit me traktorët tuaj, të dy traktorët e
14 kishin motorin ndezur apo jo?

15 Pë. Nuk po e kuptoj.

16 Py. Të dy ju po ngisnit, po vozisnit traktorët tuaj. Ti me
17 traktorin tënd, traktori tjetër me shpejtësi më të madhe dhe
18 të ka parakaluar, a është kështu?

19 Pë. Po, se mue mu ka duhur më kadalë me vozit se kisha të
20 plagosurit.

21 Py. Po, dhe ishte rrugë malore apo jo?

22 Pë. Rrugë malore, naltësi mbidetare afër 700 metrave.

23 Py. A ishte e pjerrët?

24 Pë. Shumë e pjerrët se me konë rrafsh kisha shku veç me
25 traktor e jo nga dy përpara. Me nga dy traktorë edhe problem.

1 Py. A ishit me marsh të ulët, me marsh të ulët, me shpejtësi
2 të vogël?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Bëni
4 pyetje të hapura.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

6 Py. Atëherë në cilin marsh e kishit traktorin kur po ecje në
7 këtë rrugë malore dhe po i ngjiteshe sipër malit? A ishte me
8 shpejtësi të vogël apo me shpejtësi të madhe?

9 Pë. Po të tregoj në atë gjuhën tonë, a e kupton, në të tretën
10 së pari, në gjysë bllokade.

11 Py. Pra kemi arritur të kemi një sqarim, pasi kemi bërë disa
12 përpjekje që janë dy traktorë. Ju kishit rimorkio, ishit në
13 një rrugë malore dhe kur traktori tjetër me këta dy persona
14 erdhi për t'ju parakaluar juve, ishte në krahun tuaj, u
15 dëgjua, "Cali, Cali". A ishte duke rënë shi në atë kohë?

16 Pë. Po.

17 Py. Në atë kohë, emri Cali, nuk ishte me rëndësi për juve apo
18 i dëgjuar. Nuk kishte ndonjë domethënie të veçantë?

19 Pë. Absolutikisht asnjë domethënie s'e ka pasë.

20 Py. Por 23 vjet më vonë ty të kujtohet që kur ky traktor
21 ishte duke ju parakaluar, ishin dy traktorë me motorët e
22 ndezur në një rrugë malore, ty të kujtohet tani dhe thua sot
23 që ke dëgjuar një person i cili ka thënë tjetrit, "Cali, nga
24 cili drejtim të shkojmë?" Kjo është dëshmia e juaj sot?

25 Pë. Po.

1 Py. Të flasim për rastin tjetër kur ju ndaluar për nevoja
2 personale. Thatë më herët që kishte mundësi që njëri nga këto
3 dy personat që ndodheshin në traktor të jetë afruar tek
4 rimorkio. A të kujtohet që e ke thënë këtë gjë?

5 Pë. Po.

6 Py. Kur e ndalove traktorin për të kryer nevojat personale a
7 ishte ky në momentin kur traktori tjetër ishte 200 metra
8 përpara traktorit tënd?

9 Pë. Po. Unë e kam ndal traktorin për nevoja. Ai ka ardhë,
10 rikthehet me traktor. Më pyet çka ndodhi. Unë i tregova e
11 q'atë periudhë, me sa më duket mu se u konë tu ra shumë shi i
12 madh, mos ka avitur tu prekolic aty najlloni dhe që aq.

13 Py. Tani po thoni që gjatë kësaj ndalese ke biseduar, ke
14 folur me këtë personin që u afruar tek rimorkio?

15 Pë. "Ç'ka ndodhi? Asgjë s'ka ndodhë?"

16 Py. Po më parë thatë që nuk ishe i sigurtë fare nëse një
17 person i është afruar rimorkios. Tani po thoni që edhe keni
18 biseduar me të. Kur në deklaratën që i keni dhënë palës
19 Mbrojtëse ju nuk keni thënë që keni biseduar me këto dy
20 persona, me ndonjërin nga këto dy persona, apo me njërin nga
21 këto dy persona.

22 Py. Unë nuk e quj bisedë, "Çka ndodhi?" Nuk e kom pa të
23 arsyeshme me deklaruë se mu ka duk shumë e paarsyeshme "ç'ka
24 ka ndodhë?" "Asgjë s'ka ndodhë. Kam nevoja personale të miat."
25 Që kaq. S'mu ka duk e arsyeshme me e sqaru atë.

1 Se 23 vite tash çdo detal, çdo imtësinë është bukur
2 problem ajo.

3 Py. Po, por sot - dhe besoj se është në rreshtin 13, pala
4 Mbrojtëse të pyeti. Të pyeti para një ore, një ore e gjysmë:

5 "Gjatë këtij udhëtimi kur kishit arritur në Rimanishte a
6 ke patur ndonjë kontakt me këto dy persona?"

7 Dhe thatë. Dhe e thatë në mënyrë me gojën plot, thatë:

8 "Absolutisht, jo"

9 A të kujtohet që e thatë një gjë të tillë sot?

10 Pë. Po.

11 Py. Ndërkohë që tani po thoni që keni shkëmbyer disa fjalë
12 kur ti ndalove për të kryer nevojat personale. Pra ajo që po
13 pyes është: A e keni kujtesën të freskët për ato ngjarje tani
14 edhe pas 23 viteve z. Rrahimi?

15 Pë. Po, s'muj me pasë kujtesën aq të freskët se 23 vite kanë
16 qenë.

17 Py. Pra cila është përgjigjja e vërtetë për pyetjen që ju
18 është bërë, a keni patur kontakte me të? Përgjigjja juaj
19 është: "Absolutisht jo" apo përgjigjja juaj është "po"?

20 Pë. Jo, absolutikisht, vetëm kur e kam ndalë traktorin, "Ça
21 ka ndodhë?" "Kurrë s'ka ndodhë. Për nevoja të mia
22 personale." Që kjo ka qenë. Asnjë bisedë tjetër s'kam.

23 Py. Po pala Mbrojtëse, Avokati Mbrojtës të pyeti nëse kishe
24 patur kontakt me këto dy persona gjatë këtij udhëtimi dhe
25 përgjigjja juaj ishte: "Absolutisht jo". Përgjigjja juaj ishte

1 pohuese, e plotë. Nuk thatë kam folur shkurtimisht kur
2 ndalova. Por ti the atëherë, "Absolutisht, jo". Ndërsa tani më
3 duket sikur po ndryshoni mendjen. Si e shpjegon këtë?
4 Pë. Nuk po ndryshoj mendjen. Absolutikisht s'jam ka e
5 ndryshoj mendjen, po nuk e llogarit unë një bisedë. S'e kam
6 llogarit bisedën, "Çka ka ndodhë?" "Kurrëgjja s'ka ndodhë". S'e
7 vlerësoj bisedë atë unë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Dëshmitar, këtu ke bërë betimin për të na treguar të vërtetën.
10 Dhe po ju kujtoj që e keni për detyrë ta bëni këtë. Ne e
11 trajtojmë me shumë rëndësi këtë çështje. Të lutem na tregoni
12 të vërtetën pasi unë dëgjoj diçka që mund të jetë kundërshti
13 dhe nuk jam shumë e qartë. Kështu që përpiquni dhe ... mos i
14 shikoni ata. Na shikoni ne. Bëni të pamundurën për të na
15 treguar të vërtetën.

16 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

18 Py. Po flasim për një bisedë. Ti mund të mos e mendosh që kjo
19 është bisedë, po a mendon që ky është kontakt që ke patur me
20 një person?

21 Pë. Po, kontakt.

22 Py. Po pyes - kjo është pyetja që të bëri Avokati Mbrojtës, a
23 ke patur kontakt me këto dy persona. Ai nuk pyeti nëse ke
24 biseduar me ta, ai pyeti nëse ke patur kontakte me ta. Dhe
25 përgjigjja ishte: "Absolutisht, jo". Atëherë si mund të ishe i

1 sigurt para një ore që kjo gjë nuk ka ndodhur, ndërkohë që
2 tani po të kujtohet që jo vetëm ke patur kontakt, por ke
3 shkëmbyer disa fjalë me këtë person? Cila nga këto është e
4 vërteta?

5 Pë. Ja s'po e kuptoj unë. Diçka s'po funksionon. Kontakt në
6 distancë tri metra unë nuk e llogariti kontakt atë. Edhe jam
7 tu ta them shumë të vërtetën. Edhe biseda, "Ça ka ndodhë?"
8 "Kurrë s'ka ndodhë". Që kaq. Kaq shkurt ka qenë ai takim.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
10 kjo, kjo që ka ndodhur quhet kontakt z. Dëshmitar. Nuk kemi
11 lojë fjalësh. Është mënyrë kontakti. Nuk mund ta them ndryshe.

12 DËSHMITARI: Unë s'e kam llogarit kontakt. Kjo ka mujt me
13 më ikë që s'e kam kuptu. E s'mu ka dukur e arsyeshme me thonë
14 kontakt.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
16 thashë dhe kolegu im e ka përsëritur gjithë kohën ti po i
17 kthen sytë nga pala Mbrojtëse. Nuk duhet t'i hidhni sytë nga
18 ata. Sytë duhet t'i kesh nga ne, kur përgjigjesh për gjëra që
19 kanë ndodhur në atë kohë.

20 Ajo që po dëgjoj tani nga goja jote kur po flasim për
21 "kontakte," "biseda," "shkëmbim fjalësh," ato që janë
22 regjistruar pra në transkript.

23 Dhe po e them me fjalët e mia pasi nuk dua t'i vë fjalët
24 në gojën tënde, por thatë në një moment të caktuar thatë që
25 nuk ke patur kontakt me të. Dhe kur është bërë kjo pyetje unë

1 e kam kuptuar që nuk ka patur shkëmbim bisede, nuk keni
2 shkëmbyer asnjë fjalë, asgjë nuk është thënë.

3 Më vonë kur ju pyeti z. Prokuror, na tregove se
4 përkundrazi ka patur një shkëmbim bisede, është bërë një
5 shkëmbim fjalësh mes teje dhe atyre. Dhe për sa më përket mua
6 kjo është një kundërshti. Ti ke ardhur këtu për të shpjeguar
7 veten dhe dua të dëgjoj se çfarë ke nënkuptuar me këtë. Edhe
8 njëherë do ta jap fjalën për ta shpjeguar pasi deri tani unë e
9 kam kuptuar që ti ke thënë që - kur the që "nuk ke patur
10 kontakt", nuk e kishe paramenduar si kontakt shkëmbimin e dy
11 fjalëve njëri me tjetrin. Këtë po thua tani?

12 DËSHMITARI: Kontakt, unë q'ashtu po e llogaris, kontakt.
13 Se nuk kemi bisedu na vetë çka ka ndodhë, kurrëgjja vetëm. Unë
14 për q'atë s'e kom deklaruar që kom pasë kontakt.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
16 Po e lëmë për momentin këtë. Po përpigësja të shpjegoja ku
17 mund të ketë ndodhur keqkuptimi.

18 Avokati Mbrojtës ka diçka për të thënë

19 Z. Dëshmitar hiqi pak dëgjueset ju lutem.

20 Avokat Mbrojtës, fjala është për ju.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk mendoj
22 se po luajmë me fjalët, në asnjë formë, por mendojmë se
23 perceptimi ose mënyra sesi një person e kupton të njëjtën
24 fjalë me një person tjetër mund të jetë e ndryshme. Mendoj
25 mbase kjo po ndodh këtu, mënyra sesi e kupton.

1 The nëse del përsëri ky aspekt, kjo temë mbase duhet të
2 kuptojmë çfarë, duhet të kuptojmë çfarë nënkupton dëshmitari
3 me fjalët që thotë në vend që ne ta përcaktojmë - më fal - ta
4 përkufizojmë çfarë është e çfarë nuk është kontakt. Shumë herë
5 personat përdorin një fjalë dhe e kuptojnë ndryshe. Një fjalë
6 ka kuptime të ndryshme.

7 Mendoj se dëshmitari ka nevojë t'i përgjigjet pyetjes por
8 sidoqoftë mendoj nëse ai e kupton ndryshe fjalën, ndryshe nga
9 ne të njëjtën fjalë, atëherë nga Trupi Gjykses apo Prokurori,
10 kjo është normale. Po le t'i japim mundësinë që ai ta
11 shpjegojë sesi e kupton ai këtë term.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Avokati Mbrojtës, mendoj se z. Dëshmitar, domethënë z.
14 Dëshmitar, Trupi Gjykses i ka dhënë disa herë mundësinë ta
15 shpjegojë. Pajtohem me ato çka po thoni ju dhe ne këtë po
16 përpiqemi të bëjmë.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua t'i japim mundësinë që
18 Prokurori ta pyesë e të përgjigjet.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
20 lëmë për momentin, z. Avokat.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
22 Py. Në faqen 13 mbetemi, ku ju pyetëm a kishit ndonjë kontakt
23 me këta dy persona. Ju thatë, "Absolutisht, jo." Pastaj pala
24 Mbrojtëse vazhdoi t'ju pyeste:

25 "Këta dy persona, a ka mundësi..." -

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Prokuror, ju kërkojmë ndjesë. Duhet t'i kisha thënë z.

3 Dëshmitar, të vendoste dëgjueset.

4 Kështu që do t'i kërkojmë që të vendosë dëgjueset.

5 Ju lutem t'i japim mundësinë z. Dëshmitar të vendosë

6 dëgjueset edhe të bëni edhe njëherë pyetjen.

7 Jo, është dhe përgjegjësia ime.

8 Ndjesë, z. Dëshmitar, nuk iu thamë që të vendosnit

9 dëgjueset.

10 Z. Prokuror, ju lutem përsërisni pyetjen edhe njëherë.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

12 Py. Diskutuar këtë aspektin që a kishe pasur ti ndonjë

13 kontakt me këto persona dhe the, "Absolutisht, jo." E

14 shpjegove pse na e the kështu.

15 Pastaj pala Mbrojtëse vazhdoi dhe tha:

16 "Këta dy persona a ishte e mundur për ata t'i afroreshin

17 Kapllan Parduzit dhe Nuredin Ibishit, t'u flisnin atyre?"

18 Dhe ti u përgjigje:

19 "Në një moment, s'jam i sigurt në ç'moment saktësisht,

20 pastaj Koliqit s'e njihja mirë zonën aty."

21 The:

22 "Ndalum për nevoja personale..."

23 Dhe në këtë moment na the që pasi u ktheve, pasi mbaruat

24 nevojat personale, shkëmbyet pak llafe më këta persona, me një

25 nga këta persona, apo jo?

1 Pë. Jo, nuk thashë se kom shkëmby, ka pasë mundësi -

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Prokuror, nuk tha këtë dëshmitari, si e kuptova unë.

4 Ju kërkoj të citoni saktësisht çfarë ka thënë se nuk dua
5 që ta ngatërrojmë dëshmitarin.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndjesë. Faqja 13, në fillim të
7 faqes 14. Rreshti i fundit i faqes 13 dhe pastaj fillon në
8 faqen 14.

9 Py. "Ndalua për nevoja personale. Mendoj se traktori ishte
10 para nesh, po nuk mund të them a e pashë apo jo se nuk e njoh
11 këtë pjesë të rrugës, të udhëtimit, por mesa kujtoj, po. Nuk
12 ishte më shumë se dy minuta."

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kjo është në faqen 14, rreshti
14 1 deri në 4.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

16 Dëshmitar, i heq pak dëgjueset të lutem. Ju kërkojmë ndjesë
17 për këtë.

18 Po shkoj tek rreshti - atëherë po shkoj tek faqja 44,
19 rreshti 22. Më lejoni të lexoj pak çfarë është thënë këtu. A
20 nuk ishte diku tjetër që z. Dëshmitar tha kur foli, kur
21 bisedoi? Se unë s'e mbaj mend që ai ta ketë thënë shprehimisht
22 që ka folur, shkëmbyer ato llafet pasi kishte mbaruar nevojat
23 personale.

24 Nuk dua që ta pyesim disa herë të njëjtën pyetje, t'i
25 bëjmë disa herë të njëjtën pyetje.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Okej, një moment. Më lini një
2 çast. Duhet të filloj nga faqja 40 atëherë. Faqja 40, rreshti
3 17, të nderuar Gjykatës.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 Py. "Kur ndaluar traktorin për nevoja personale, atëherë
6 traktori tjetër ishte 200 metra përpara?"

7 "Po, ndalova traktorin dhe filloi të voziste mbrapa në
8 revers traktori.

9 "Po, e kuptoj.

10 Pastaj e pyeta, "Po i fole atij në këto momente?"

11 Sepse nuk e kisha thënë më përpara këtë.

12 Dhe ai tha:

13 "Nuk e quaj këtë bisedë, në qoftë se pyet diçka çka
14 ndodhi sepse - nuk e thashë sepse nuk ishte e rëndësishme.
15 Kisha ndaluar për nevoja personale."

16 Si e kuptoj unë është që traktori eci mbrapa, eci në
17 revers kur dëshmitari kishte ndaluar për nevoja personale. Dhe
18 në këto momente mund të kishte ndodhur ky shkëmbimi.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
20 ti the që ndodhi kur kishte mbaruar nevojat personale. Dhe nga
21 kjo pjesë e provës që dha ai, nga kjo pjesë e dëshmisë që dha
22 ai, ai nuk e tregon momentin, nuk e thotë momentin kur e ka
23 pasë këtë shkëmbim. Ti po thua që ka ndodhur kur i kishte
24 mbaruar nevojat personale.

25 Kjo është mbase një pjesë që duhet ta qartësojmë dhe ta

1 pyesim kur ka ndodhur. Ky ishte thelbi i asaj që doja të
2 thoja.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mbase s'isha i saktë. Mund të
4 ketë qenë dhe para.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Po, po hymë në
6 shumë hollësi, kështu që duhet të jemi të saktë në ato që po
7 themi.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

9 Py. Z. Dëshmitar, ndaluar për nevojat personale.

10 Z. Dëshmitar i the Trupit Gjykses sot që ndalove për
11 nevoja personale në një moment. Në ato momente, traktori që
12 ishte para jush, 200 metra para jush filloi të ecte në revers
13 mbrapsht, mbrapa, a është kështu?

14 Pë. Po, saktë.

15 Py. Në rregull. Në këtë moment ju shkëmbyet pak fjalë me një
16 nga personat. Kur ndodhi ky shkëmbim, kishit zbritur nga
17 traktori ju dhe po shkonit 15 metra larg për nevoja personale
18 apo ky shkëmbimi, këto llafe u shkëmbyen kur ishte ndërkohë
19 ende mbi traktor?

20 Pë. Jashtë traktori ka qenë në rrugë: "Çka ka ndodhë?"

21 "Kurrëgjjo s'ka ndodhë, në rregull është, për nevoja personale."

22 Edhe që kaq.

23 Py. Në rregull. A ju kujtohet nëse fole me këtë person para
24 apo pasi kreve nevojat personale.

25 Pë. Pasi me i kry nevojat personale.

1 Py. Në rregull. Sepse pasi thatë, pasi the që nuk kisha pasur
2 asnjë lloj kontakti me këta persona, na shpjegove prapë çfarë
3 kishte ndodhur. Dhe the:

4 "Në një moment nuk jam i sigurt në cilën pjesë të
5 udhëtimit..." the.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po më duket se kjo ka ndodhur
7 në faqen 13 të transkriptit, rreshti 24, the:

8 "Po, ndalova për nevoja personale. Pas Koliqit nuk
9 isha... por ndalova për nevoja personale dhe traktori ishte
10 para nesh, po nuk mund të them a e pashë apo jo."

11 Kujt i referohesh kur thua nuk isha i sigurt a e pashë
12 apo jo. Për kë e ke fjalën?

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është rreshti 14, faqja 14 më
14 falni, rreshti 2.

15 DËSHMITARI: I kom referue se mesa e kuptova unë pyetjen,
16 qe pyetja: "A ka bisedue Cali me Korabin, a avitet te
17 traktori?" që ashtu më...

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

19 Py. Po, po. Nëse njëri nga personat iu afrua traktorit. Dhe
20 the: Nuk jam i sigurt a e pashë atë person apo jo. Kështu
21 thatë.

22 Pë. Saktë.

23 Py. Nuk the, nuk the që kishe bërë ndonjë bisedë me këtë
24 personin në atë moment.

25 Pë. Biseda me atë personin ka qenë para se me u avitë ai tek

1 traktori.

2 Py. Pra, para. Sa larg ishte personi nga traktori kur e bëtë
3 këtë bisedën?

4 Pë. Po ishte - te na është një traditë që kur ke nevoja
5 personale ashtu, nuk dalim në rrugë. Kalojmë pak rrugës edhe
6 unë isha me vrap me hi në mal ma poshtë, jo në rrugë. Edhe
7 q'atë bisedë e kom bo unë.

8 Py. Në ç'a distance? Sa larg ishte ky personi? Sa larg ishte
9 personi? Në ç' distancë ishte ky personi kur i fole, kur e bëtë
10 këtë bisedën?

11 Pë. 7-8 metra, 10. S'kishim, s'kam pasë GPS metër me mat.

12 Py. Në fakt, nuk e përmendët sot këtë kontaktin tek deklarata
13 që i dhatë Mbrojtjes dhe po e përmendni për herë të parë tani.

14 Edhe njëherë të fundit po të pyes. Ka ndonjë arsye pse
15 t'u kujtua tani kur fillova të të pyes unë? A ka ndonjë arsye
16 pse tu kujtua tani ky takimi? Sepse nuk e kishe përmendur më
17 përpara.

18 Pë. Po, se unë kontakt e kom llogarit me atë personin që fol,
19 bisedon 2 minuta, 3 minuta, kontakt veç përshëndetje, s'e kom
20 llogarit kontakt. Që kjo është arsyeja vetëm.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

22 Prokuror, unë do ta lija për momentin këtë. Do ta lija këtë.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më jepni një çast ju lutem.

24 Do të doja në qoftë se është e mundur ta bënim pushimin
25 në orën 12.00, e nderuar Gjykatëse.

1 [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
3 planifikonim të bënim një orë e gjysmë seancën, kështu që
4 filluam në orën 12 pa dhjetë. Më falni 11 pa dhjetë. Më falni
5 11 pa dhjetë. Do të vazhdojmë deri në orën 12.20. Kishim
6 planifikuar të bënim një seancë një orë e gjysmë.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Atëherë e nderuar Gjykatëse nuk
8 kam më pyetje të tjera për këtë dëshmitar. Faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit z. Prokuror.

11 Mbrojtësja e Viktimave a jeni ju gati t'i bëni pyetje
12 dëshmitarit?

13 Z. VOSENBERG: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për këtë
14 dëshmitar.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Sigurisht dhe kjo ishte një mundësi që unë nuk e përfshiva në
17 parashtrimin tim.

18 Në rregull atëherë. Atëherë nga sa kam unë informacion,
19 pala Mbrojtëse, më falni, për informacionin tim desha të pyes
20 palën Mbrojtëse a ka pyetje shtesë?

21 Z. SHALA: [Përkthim] Po, kemi vetëm një pyetje, e nderuar
22 Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
24 jeni gati ta bëni tani?

25 Z. SHALA: [Përkthim] Po, tani.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Atëherë po ua jap fjalën tani.

3 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit.

4 Pyetje vijuese nga z. Shala:

5 Py. Zotëri dëshmitar, sot në kohën kur u ndërpre, ishim,
6 shkuam në pauzë, në pushim pasi që unë ju parashtrova juve
7 pyetjet, a kemi pasë na kontakt?

8 Pë. Jo.

9 Py. Kur keni pasë për herë të parë kontakt me mu si Mbrojtës
10 i Salih Mustafës?

11 Pë. Hera e parë sot.

12 Py. Faleminderit.

13 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk kam pyetje
14 të tjera.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
16 ishte pyetja juaj?

17 Z. SHALA: [Përkthim] Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, Avokati Mbrojtës.

20 Mirë atëherë, z. Prokuror, keni pyetje shtesë?

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Atëherë nuk ka as pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave.

24 Atëherë të shohim pak planifikimin për pyetjet. Ju kanë
25 drejtuar pyetje, pala Mbrojtëse, Prokuroria dhe tani është

1 radha e Trupit Gjykses për të parë nëse kemi nevojë për
2 qartësime lidhur me aspektet për të cilat keni dhënë prova
3 dëshmisë sot, në mënyrë që të ndihmoni Trupin Gjykses që të
4 gjejë të vërtetën.

5 Të pyes kolegët e mi nëse kanë pyetje. Unë nga ana ime
6 nuk kam asnjë pyetje.

7 As unë nuk kam asnjë pyetje.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Atëherë, e keni fjalën.

11 Pyetje nga Trupi Gjykses:

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Dëshmitar, sot paradite
13 thatë në faqen 14, rreshtat 11 deri në 13 të transkriptit,
14 thatë:

15 "Pas 48 orësh, mbërritëm në Rimanishte. Kjo ndodhi më 8
16 deri në 10 prill."

17 A je i sigurt për këtë?

18 Pë. Jo, s'ka ndodhë më 8 prill. Prej 10 prillit. Në 9 ka qenë
19 ofensiva, më 9 prill. Më 10 janë plagosë ata, jo më 8.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Atëherë sa
21 zgjati? Sa zgjati, sa kohë mbajti për të shkuar në Rimanishte?

22 Pë. 48 orë.

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Në deklaratën që
24 i keni dhënë Mbrojtjes, shpjegoni - dhe ne e diskutuam me
25 shumë hollësi sot - po thjesht për ta qartësuar për veten

1 time. The deri ne Koliq. Kjo është DSM00094.

2 "Deri në Koliq s'kishte kurrfarë problemi. Po pastaj kur
3 arritëm në Koliq erdhën dy persona të na shoqëronin deri në
4 Rimanishte. Po na tregonin rrugën që duhet të ndiqnim."

5 Pastaj thua - ju pyesin - a i njihni këta persona? Jo,
6 the. Emrat ua di? Jo s'i mbaj mend, the, po të paktën dy herë
7 dëgjova që thirrën "Cali, Cali".

8 Unë nuk po hyj tek ky aspekt, tek kjo pjesë, më falni, po
9 thjesht dua të sqaroj nëse ky personi erdhi vetëm nga Koliqi
10 deri në Rimanishte kështu?

11 Pë. Ky personi prej Koliqi na ka përcjellë në Rimanishte. Nga
12 Koliqi në Rimanishte.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Sa kohë mbajti nga Koliqi
14 deri në Rimanishte? A të kujtohet sa mbajti nga Koliqi në
15 Rimanishte?

16 Pë. Nuk di se s'kena pasë orë për Zotin, s'di. S'di. Nuk mund
17 ta përshkruej se s'kena pasë GPS me vete, në traktor osht
18 llum.

19 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Sepse në faqen 38, në
20 rreshtat 2 dhe 3 po flisni për këtë traktorin me dy persona që
21 ju shkëmbyen me ju dhe the, ishte ora, rreth ora 4.00-5.00 e
22 pasdites ke thënë. Dhe ka qenë rreth ora 4.00 ose 5.00 kur ju
23 u shkëmbyet në Koliq.

24 Pra 4.00-5.00 besoj që është dita pasi ishit larguar nga
25 Turiqica. Pra jemi më datën 11 prill apo 12 prill këtu, cila

1 datë i bie të jetë?

2 Pë. Me 10 prill, i ka ndodhë plagesa e dy personave në
3 fshatin Surdull. E shpjegova. Me 10 prill kena marrë
4 udhëtimin na për Rimanishte nga Turiqica, Rakinicë, Bllatë e
5 të gjitha ato fshatrat të cilat i përmenda, që ka nevojë prapë
6 t'i përmendi.

7 Me dy persona në traktor, na kanë përcjellë deri në
8 Koliq. Në Koliq, në një pjesë të Koliqit ata dy persona janë
9 kthy se e kanë ditë terrenin. Kanë ardhë dy persona të tjerë
10 me një traktor, jo me dy traktora, po me një traktor edhe ata
11 na kanë përcjellë deri në Rimanishte.

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] E kuptova shumë qartë këtë.
13 Po nëse kthehem tek harta që ju treguam më përpara ju kaluat,
14 filluat në Turiqicë, pastaj në Rakinicë, pastaj Bllatë [sipas
15 përkthimit] pastaj Ballaban dhe pastaj Koliq. Dhe pastaj pas
16 Koliqit është vetëm Sharbani dhe Rimanishti.

17 Pra është afër fundit, afër fundit të udhëtimit që është
18 afruar ky traktori me këta dy persona. Kur keni qenë afër
19 fundit të udhëtimit, pra është afruar traktori me dy personat.
20 Pë. Po. Afër fundit është.

21 GJYKATËSI BITTI: Në rregull. Pra ky traktori me këta dy
22 personat erdhi vetëm afër fundit të udhëtimit që ka qenë diku
23 mes Koliqit dhe Rimanishtes. A e kam kuptuar saktë? O "Po" ose
24 "Jo" mjaft kaq.

25 Pë. Po.

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
2 të tjera, znj. Kryetare e Gjykatës, më falni znj. Gjykatëse.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. Rrahimi, mbërritëm në fund të dëshmisë tuaj. Do të
6 doja t'ju falënderoja për përpjekjet tuaja në seancën e sotme
7 për dëshminë tuaj. Jam e bindur që do të na ndihmojë në
8 përpjekjet tona për të gjetur të vërtetën. Faleminderit.

9 Do t'i kërkoj znj. Asistente të Gjykatës t'ju shoqërojë
10 jashtë sallës së gjyqit. Ju urojmë rrugë të mbarë dhe ju
11 kujtoj se nuk duhet ta diskutoni dëshminë që keni dhënë para
12 Dhomave të Specializuara me askënd. Faleminderit edhe njëherë.

13 DËSHMITARI: Faleminderit.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit, znj. Asistente e Gjykatës.

17 A ka ndonjë gjë që duan të parashtrojnë palët?

18 Z. Prokuror.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Mbrojtësja e Viktimave.

22 ZNJ: VOSENBERG: Jo, e nderuar Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala
24 Mbrojtëse.

25 Z. VON BONE: Jo, e nderuar Gjykatëse.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull atëherë. Atëherë në rast se nuk ka gjë tjetër për të
3 diskutuar, do të mblidhemi të enjten, më 20 prill në orën 9.30
4 me dëshminë e Dëshmitarit 1300. Dhe kam parë që javën tjetër
5 janë dhënë edhe listat nga pala Mbrojtëse për të gjithë
6 dëshmitarët që do të dëshmojnë javën tjetër.

7 Seanca mbyllet këtu.

8 --- Seanca mbyllet në orën 12.04

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25